



"Porti Detar" Vlorë

PLANI VJETOR I PUNËS PËR VITIN 2023 NË LIDHJE ME MENAXHIMIN FINANCIAR DHE KONTROLLIN

Ky plan pune hartohet në zbatim të detyrave që përcakton ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 *"Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin"*, Strategjisë së menaxhimit të riskut të hartuar dhe të paraqitur për miratim dhe është pjesë e punës së Grupit të Menaxhimit Strategjik. Ky plan do të hartohet çdo vit dhe është pjesë e Planit Strategjik për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Ky plan mund të rishikohet gjatë vitit. Gjithashtu duhet të theksojmë se plani i punës shërben për orientimin e përgjithshëm dhe jo duke i parë në hollësi situatat të cilat dalin gjatë zbatimit të procesit të punës në sektorë të ndryshëm.

Ky Plan duke qënë i pari në zbatim të koncepteve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, do të shërbejë si bazë për krijimin e një mjedisi ku menaxhimi financiar dhe kontrolli të ngrihen në një nivel me të lartë, e gjitha në funksion të realizimit të objektivave që ka *"Porti Detar Vlorë"* sh.a.

Duke qënë se është hera e parë e hartimit të këtij plani dhe konceptet e paraqitura mund të mos jenë të njohura, e theksojmë se është e nevojshme të kihet parasysh ashtu siç paraqitet dhe në manualin përkatës se sistemi i kontrollit të brendshëm mund të ofrojë për administratorin vetëm garanci të arsyeshme dhe jo absolute, lidhur me arritjen e objektivave që ka një shoqëri publike dhe në rastin konkret *"Porti Detar Vlorë"* sha. Garancia e arsyeshme nënkupton një nivel të kënaqshëm sigurie duke patur në konsideratë kostot, përfitimet dhe risqet. Përcaktimi se kur garancia bëhet e arsyeshme varet nga gjykimi i administratorit.

Ky plan do të shërbejë si një mjet pune i brendshëm për të siguruar fillimin e një pune mbi konceptet e parashikuara në ligjin *"Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin"* dhe në udhëzimet përkatëse, për të ndihmuar *"Portin Detar Vlorë"* sh.a në zhvillimin praktik të procesit, raportimit dhe ndjekjes së çështjeve për t'u diskutuar.

Hapat që do të ndërmerren gjatë katër mujorit të parë të vitit parashikojnë:

1. Njohjen në nivel manaxherësh me konceptet bazë të kontrollit të brendshëm me pesë komponentet e tij:
 - Mjedisi i kontrollit
 - Menaxhimi i riskut
 - Aktivitetet e kontrollit
 - Informacioni dhe komunikimi
 - Monitorimi
- *Mjedisi i kontrollit* — i cili përfshin integritetin, vlerat etike, kompetencën e personelit, filozofinë e menaxhimit, stilin e kryerjes së operacioneve, mënyrën në të cilën menaxhimi i njësisë adreson autoritetin dhe përgjegjësinë si dhe vëmendjen e drejtimit ndaj ambientit të kontrollit të brendshëm.

- *Vlerësimi i riskut* — Një parashikim mbi vlerësimin e risqeve që mund të ndikojnë në realizimin e objektivave të qëndrueshme. Vlerësimi i riskut ka të bëjë me identifikimin, analizën si dhe menaxhimin e risqeve të mundëshme të cilat mund të ndikojnë ose dëmtojnë realizimin e objektivave të organizatës.
- *Aktivitetet e kontrollit* — Këto janë politika dhe procedura të cilat ndihmojnë për të garantuar nëse janë përmbushur direktivat e menaxhimit. Kontrolli i aktiviteteve ndihmon në garantimin nëse janë ndërmarrë veprimet e nevojshme dhe të duhura me qëllim që të adresohen risqet të cilat mund të dëmtojnë arritjen e objektivave dhe qëllimeve të shoqërisë. Së fundmi kontrolli i aktiviteteve përfshin vlerësimin e një rradhe të gjerë aktivitetsesh si: aprovimi, autorizimi, verifikimi, rakordimi, rishikimi i performancës së operacioneve dhe ndarjen e detyrave për të minimizuar riskun nga pa pajtueshmëria midis këtyre funksioneve.
- *Informacioni dhe Komunikimi* — i takon vlerësimit nëse informacionet përkatëse identifikohen dhe raportohen në formën e duhur, kohën e duhur si dhe mundësojnë që personeli në mënyrë efektive mund të kryejë përgjegjësitë që ka. Sistemet e informacionit duhet të prodhojnë raporte me përmbajtje operationale, financiare dhe të pajtueshmërisë, me qëllim që të bëhet i mundur menaxhimi i tyre, dhe për të kontrolluar veprimtarinë e shoqërisë.
- *Monitorimi* — Sistemi i kontrollit të brendshëm nevojitet të jetë i monitoruar. Kjo nënkupton që në mënyrë të vijueshme dhe sistematike menaxhimi duhet të vlerësojë performancën e sistemit të kontrollit të brendshëm, të zbulojë dhe korrigjojë në kohë dobësitë e tij.

Ketë pikë do ta konsiderojmë veçanërisht të rëndësishme pasi niveli manaxherial do të shërbejë si pjesë kryesore e zbatimit të këtij sistemi jo vetëm në këtë nivel, por edhe në nivel zbatues. Për këtë qëllim duhet të vihen në dispozicion materialet e botuara, do të organizohen konsultime të ndryshme dhe sa më shumë të jetë e mundur trajnime. Pjesën e trajnimeve do ta konsiderojmë si prioritet, pasi siç e kemi përmendur dhe më lart, kemi të bëjmë me koncepte të pa praktikuar më parë dhe me një këndvështrim të ri të problemit. Gjithashtu çdo komponent do të trajtohet në mënyrë të veçantë. Me tej këto koncepte duhet të transmetohen në nivelin më poshtë duke arritur mundësisht të çdo punonjësi i shoqërisë “Porti Detar Vlore” sha. Veçanërisht në fazën fillestare kjo ngelet një detyrë primare pasi njohja e këtyre koncepteve do të reflektohet dhe në zbatimin sa më të mirë të tyre në praktikë. Rëndësi në këtë kuadër do të marrë Grupi i Menaxhimit Strategjik i cili do të jetë terësisht në funksion të njohjes dhe zbatimit të këtij sistemi të ri të kontrollit të brendshëm.

2. Duke qenë se në “Portin Detar Vlorë” sha ka një staf drejtuesish që në përgjithësi kanë experience të mjaftueshme pranë kësaj shoqërie, do të kemi një bazë të mirë të fillimit të punës dhe përmirsimit të saj mbi konceptet e reja që kërkohen. Si fillim do të ballafaqojmë këtë experience me kërkesat e reja duke patur si orientim disa pika të cilat në këtë plan i konsiderojmë të domosdoshme:
 - Informacioni kryesor financiar, operacional dhe menaxherial është në përputhje me rregullat si dhe i saktë, i besueshëm dhe në afat.
 - Veprimet e stafit të “Portit Detar Vlore” sha janë në përputhje me ligjet dhe rregullat në fuqi, me politikat e institucionit dhe me standartet.
 - Operacionet e punës janë të dokumentuara në përputhje, me rregullat e punës dhe standartet e etikës.



- Cilësia e punës dhe përmirsimi i saj i përgjigjen arritjes së objektivave të "Portit Detar Vlorë" sh.a. Pjesë e realizimit të këtij procesi do të shërbejë veçanërisht ballafaqimi i praktikave të brendshme ekzistuese, përfshirë rregulloren e shoqërisë, strukturën, kodet e veprimit etj të ngjashme, të cilat përfaqsojnë kornizën e punës të kësaj shoqërie në veprimtarinë e përditshme.
- Burimet përdoren me efikasitet dhe mbrohen në mënyrë adekuate.

3. Në fund të këtij ballafaqimi si më sipër, brenda muajit maj, procesi do të diskutohet në parimet se:

- Aktiviteti konsiston në politika specifike dhe procedura të caktuara për të minimizuar rrezikun për gabime, mospërputhje dhe mashtrime me karakter ose efekt financiar.

- Janë veprime konkrete apo procedura që zhvillon shoqëria për të realizuar përgjegjësitë në të gjitha nivelet e organizatës të cilat kanë të bëjnë me:

- i) Kontrollin fizik të aseteve
- ii) Ndarjen e detyrave, si; autorizimin, aprovimin e veprimeve, verifikimin, rakordimin, regjistrimin raportimin, rishikimin e feedback-ut të operacionit
- iii) Dokumentimin e përshtatshëm
- iv) Rishikimin e pavarur të performancës.

Parimet bazë në ndarjen e detyrave duhet të udhëheqin:

- a) Një ndarje të saktë dhe të qartë të detyrave
- b) Personel të kualifikuar
- c) Procedura të shkruara dhe të ndara për secilin funksion si; Autorizimin, Aprovimi, Rregjistrimin, Raportimin e transaksioneve etj.

Kjo nënkupton që detyrat të kryhen nga nëpunës të ndryshëm me qëllim mbrojtjen dhe sigurinë e aseteve fizike, parave dhe çdo pasurie tjetër.

Ndarja e detyrave duhet të garantojë që përgjegjësia për ruajtjen e aseteve, autorizimi i transaksioneve të lidhura me to, duhet të mbahen nga persona me funksione të ndara nga kontabilizimi i tyre.

Çështjet në të cilat do të ndalemi më me hollësi do të jenë:

- Ku mund të ketë përmirsim të procesit të kontrollit të brendshëm
- Si të përmirsohet cilësia dhe vlefshmëria e raportimeve
- Si të zhvillohen dhe përvetësohen praktikat më të mira
- Si të ketë një fokus më të qartë për objektivat që duhet të arrihen
- Si të përshtasë një rregull të përgjithshëm të përmirësuar në nivel manaxherial dhe në nivele më poshtë.

4. Paralelisht me njohjen dhe fillimin e zbatimit të procesit, në Zyrën e Administrimit Financiar do të fillojë puna për hartimin e mbajtjen e regjistrit të riskut brenda muajit janar. Ky regjister do të shërbejë si dokument dhe për të iniciuar diskutime të ndryshme dhe përmirsimin e punës në këtë aspekt. Gjithashtu kjo do të shërbejë që në

periudhën e mëpasme të kemi një listë të plotë të risqeve me të cilat përballët “Porti Detar Vlore” sh.a në aktivitetin e vet në funksion të arritjes së objektivave, por dhe një renditje të faktoreve që mendohet se shoqërojnë procesin.

5. Për shkak të fazës fillestare në të cilën ndodhet procesi, e konsiderojmë të domosdoshme që bashkëngjitur këtij plani pune, të ketë disa koncepte të përgjithshme për riskun të cilat kanë të bëjnë me përkufizimin dhe përshkrimin e riskut. Ky material është i karakterit të përgjithshëm dhe një pjesë e tij mund të mos jete i vlefshëm për karakteristikat specifike të “Portit Detar Vlore” sha, por do të shërbejë për krijimin e koncepteve të përgjithshme dhe mandej se cilat pjesë janë më të domosdoshme për t’u zbatuar në funksion të organizimit të punës së kësaj shoqërie, gjithnjë për arritjen e objektivave të saj. Ky material do të diskutohet në takimet e organizuara për këtë qëllim.
6. Ky plan ashtu sikurse është shprehur në krye të tij mund të rishishikohet gjatë vitit në varësi të situatave të krijuara, përvojës së grumbulluar, ballafaqimit me eksperiencat më të mira etj. Për këtë qëllim të gjithë faktorët menaxhues janë të hapur të dëgjojnë mendime dhe ide të ndryshme për përmirsimin e punës, të marrin përsipër t’i diskutojnë ato në Grupin e Menaxhimit Strategjik dhe të marrin vendimet përkatëse.

ADMINISTRATORI

Ilir Banushi

EVIDENTIMI I FUSHAVE KRYESORE TE **VEPRIMTARISË**



Në zbatim të Strategjisë së Menaxhimit të riskut, më poshtë evidentohen disa nga fushat kryesore të veprimit të "Portit Detar Vlorë" sh.a.

Fushën e prokurimeve publike.

1. Për rregullshmërinë e dosjeve.
 - Organizimi në dosje i gjithë dokumentacionit të tenderit sipas përcaktimeve ligjore.
 - Inventarizimi i dokumentave të dosjes, arkivimi.
 - Zgjedhja e procedurës së prokurimit, procedura e ndjekur.
2. Për dokumentacionin e tenderave sipas rregullave të prokurimit.
 - Përpilimi i dokumentacionit për mallrat, ndërtimet, projektimet.
 - Specifikimet teknike, grafiku i lëvrimit, kriteret e vlerësimit për mallrat.
 - Projektet e zbatimit, specifikimet teknike, vëllimet e punës dhe rradha e punimeve, afati i përfundimit, kriteret e vlerësimit për ndërtimet.
 - Detyra e projektimit dhe specifikimet teknike, afatet dhe kriteret e vlerësimit për projektimet.
3. Për respektimin e afateve.
4. Për respektimin e procedurave të prokurimit elektronik.
5. Për zbatimin e kërkesave ligjore për lidhjen e kontratave shtesë, respektimi i vlerës dhe afatit, justifikimi nevojave për bërjen e kësaj shtese.

Fushën e Financës.

1. Verifikim mbi respektimin e detyrimeve kontraktore (për arkëtimet dhe pagesat).
2. Zbatimi i rregullave të menaxhimit të aktiveve të shoqërisë.
3. Zbatimi i strukturës dhe organikës së miratuar.
4. Zbatimi i dispozitave ligjore në kryerjen e pagesave për pagat e punonjësve, shtesave mbi to, shpërblimeve dhe shpenzimeve për udhëtim e dieta.
5. Dokumentimi i të dhënave për personelin.
6. Zbatimi i dispozitave ligjore në kryerjen e ndalesave për tatimin mbi të ardhurat personale, për detyrimin ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetsore, xhirimi në favor të buxhetit të shtetit.
7. Zbatimi i dispozitave ligjore për shpërblimet e dhëna nga fondi i veçantë për rezultate të mira në punë.
8. Zbatimi i dispozitave ligjore për orët e punës të kryera mbi kohën normale të punës dhe për ditët e pushimi vjetor të pakryer.
9. Hartimi dhe zbatimi i buxhetit vjetor dhe atij afat mesëm.

Fushën e zbatimit të kontratave të infrastrukturës dhe të tjera, Investimeve.

- Zbatimi i ligjshmërisë në hartimin dhe zbatimin e kontratave përkatëse (Infrastrukturës, shërbimit të pastrimit, shërbimit urban, etj).
- Shqyrtimi dhe verifikimi i kërkesave për akordim fondesh.
- Verifikimi i dokumentacionit teknik shoqërues të investimit.
- Krahësimi i investimeve për financim me leverdishmërinë dhe nevojat reale.

- Verifikimi i plotësisë së dokumentacionit fillestar të investimit (plan studimi, skica, ide, leje sheshi, leje ndërtimi, etj.).
- Miratimi i procedurave të tenderimit nga organet kompetente.
- Pjesmarrja e kontributeve në investime nga shoqata, donatorë të ndryshëm.
- Verifikimi i procedurave të emërimit të drejtuesit të punimeve, kriteret që duhet të plotësojë.
- Zbatimi i legjislacionit të fushës për mbajtjen e dosjes së drejtuesit të punimeve lidhur me fazat e punimeve, sasitë, cilësisë së materialeve, grafikëve të punimeve apo lëvrimit, ndryshimet e mundshme të projekteve, specifikimeve teknike.
- Krahasimi i këtij dokumentacioni me gjendjen reale në objekt.
- Zbatimi i legjislacionit të fushës për mbajtjen e dosjes së kolaudatorit, dokumentacionit dhe krahasimi me faktin duke bërë testimet përkatëse.
- Zbatimi i rregullave për marrjen në dorëzim të objektit, ngritjen e komisionit me specialistët përkatës, mbajtjen e procesverbalit.

Fusha të tjera

- Zbatimi i ligjshmërisë për kuotën e shpenzimeve ditore për ushqime, për shpenzimet vetjake.
- Zbatimi i legjislacionit të fushës për administrimin e ndihmave humanitare.
- Vendosja dhe zbatimi i rregullave të kryerjes së inventarizimeve të aktiveve të institucionit, nxjerrjes së rezultatit dhe sistemimit të diferencave.
- Zbatimi i procedurave ligjore dhe rregullave të prokurimit publik në prokurimin e fondeve publike.
- Për strukturën, pagat, orët jashtë orarit, shpërblimet, dietat, etj referoju pikave 3-8 të fushës së financës.
- Funksionimi i veprimtarisë sipas kuadrit ligjor dhe detyrave respektive.
- Zbatimi i legjislacionit të fushës në hartimin, miratimin, zbatimin e programeve për realizimin e objektivave
- Pajtueshmëria e transaksioneve financiare dhe të veprimtarive e drejtimit me procedurat, politikat, rregullat dhe legjislacionin e fushës.

IDENTIFIKIMI I ZONAVE TË RISKUT

Identifikimi i zonave të riskut në kontekstin e fushës së veprimit të “Portit Detar Vlorë” sh.a, konsiston në përcaktimin e risqeve, mbështetur në ndarjen e risqeve në:

- Riske të brendshme dhe risqe të jashtme
- Riske në nivel subjekti dhe në nivel detyrash.

Të brendshëm mund të jenë, risku financiar/ i limiteve buxhetore; risku i IT, risku i burimeve njerëzore, etj.

Të jashtëm mund të jenë ato që shkaktohen nga faktorë jashtë shoqërisë por që e ndikojnë atë në bërjen e politikave, strategjive, strukturës, buxhetit, etj. Këto janë jashtë mundësisë së menaxhimit për t’i kontrolluar.



ANALIZA E IMPAKTIT TË RISKUT

Duke analizuar impaktin e një risku të caktuar, duhet të kemi parasysh se ky proces ka karakter vlerësimi subjektiv të kryer nga një grup analistësh apo nga vetë Grupi i Menaxhimit Strategjik të "Portit Detar Vlorë" sha.

Përcaktimi i impaktit të një risku të dhënë duhet të mbështetet në shkallën e mëposhtme të impaktit:

- I lartë – zgjidhja e problemit do të kërkojë shumë kohë/burime. Shmangia e pasojave do të jetë shumë e vështirë, ndoshta e pamundur. Ai do të ketë ndikim thelbësor mbi njësinë dhe do të përbejë një ngjarje të rëndësishme publike.
- Mesatar – zgjidhja e problemit do të kërkojë një kohë/burime mesatare. Shmangia e pasojave do të kërkojë kohë. Mund të ndodhë që të bëhet ngjarje publike.
- I ulët – zgjidhja e problemit do të kërkojë kohë, por problem nuk do të shkaktojë dëme të përhershme. Nuk do të bëhet ngjarje publike.

PERCAKTIMI I PROBABILITETIT QË RISKU TË NDODHË

Duke analizuar probabilitetin që një risk i caktuar të ndodhë, duhet të kemi parasysh se gjithashtu ky proces ka karakterin e një vlerësimi subjektiv të kryer nga një grup analistësh ose nga Grupi i Menaxhimit Strategjik të shoqërisë.

Përcaktimi i Probabilitetit që risku të ndodhë:

- I lartë: atëherë kur ka më shumë se 60 % të gjasave se risku do të ndodhë, vetëm nëse ky nuk do të zvogelohet (ose risku do të kristalizohet në formë sistematike, ose rutine).

- Mesatar: kur gjasat janë më të larta se 10 % por më të ulta se 60 % , se risku do të ndodhë, vetëm nëse nuk zvogelohet (ose risku të kristalizohet ose për shkak të koincidence të jashtëzakonshme ose rastësisht).
- I ulët: kur gjasat janë më të ulta se 10 % se risku do të ndodhë, vetëm nëse ai nuk zvogëlohet (ose risku do të kristalizohet rrallë, shfaqjet e tij do të jenë të izoluara). Grupimi i risqeve sipas impaktit dhe probabilitetit të tyre, duhet t'i japë mundësinë administratorit të shoqërisë që të përcaktojë drejtimet parësore në marrjen e masave riparuese si dhe të nxjerrë në pah kërcenimet reale në realizimin e detyrave dhe qëllimeve të subjektit.

PERGJIGJA NDAJ RISKUT

Duke përshkruar si masat e marra tashmë ashtu dhe ato të planifikuara, me karakter riparues, duhet të mbështetemi në dokumentat dhe rregulloret e brendshme të shoqërisë, të tilla si vendime të Këshillit Drejtues, urdhrat e brendshëm të titullarit, porositë me shkrim që i janë drejtuar stafit të punës por edhe tek masat e realizuara faktikisht që janë marrë deri tani në segmente të ndryshme të shoqërisë. Nëse analiza tregon se masat e marra deri tani, janë të pamjaftueshme për minimizimin e një risku të caktuar, atëherë duhet të shqyrtohen dhe të pranohen procedura dhe zgjidhje të reja, të cilat e shtyjnë riskun në një nivel më të ulët probabiliteti. Por gjithashtu duhet mbajtur mend që pergjigja ndaj riskut mund të marrë forma të ndryshme:

- Transferimi- kalimi i riskut tek një subjekt tjetër.
- Tolerimi- mundësitë e kufizuara për veprim, p.sh.: veprimet e kufizuara deri në minimumin e kërkuar nga fusha e kompetencave apo nga akti ligjor që ngarkon përmbushjen e qëllimeve të caktuara, kosto të larta të pasojave të mundshme të kristalizimit të një risku të caktuar.
- Veprimi- grupi me i shumtë. Qëllimi: dobësimi i riskut deri në nivelin e pranueshëm, veprimet e ndermarra, të përfshira nga kontrolli i brendshëm, i cili i atribuohet një nivel të caktuar drejtimi, në përputhje me nivelin e kompetencave dhe me nivelin e impaktit të një risku të caktuar.

CAKTIMI I DETYRAVE KONKRETE LIDHUR ME KUNDËRVEPRIMIN NDAJ NJE LLOJI TË CAKTUAR RISKU, PËR PUNONJËS KONKRETË TË SHOQËRISË “PORTI DETAR VLORE” SHA

Caktimi i detyrave konkrete duhet të bëhet sipas një qëllimi dhe llogjike të caktuar, në lidhje me planin vjetor të punës si dhe rregulloret dhe udhëzimet e



brendshme që rregullojnë fushën e veprimit të strukturave të ndryshme organizative dhe të punonjësve të tyre. Duhet të udhëhiqemi gjithashtu nga parimi i evitimit të shkrirjes së përgjegjësive nëpërmjet ngarkimit të një detyre, një grupi tepër të madh punonjësish.

Pas përmbushjes së kesaj etape të procesit të analizës dhe menaxhimit të riskut, duhet të kryhet një përmbledhje sistematike e konstatimeve, përfundimeve dhe synimeve të deritanishme, ëe një formë tabele sipas modeleve të rekomanduara.

KRIJIMI I HARTËS SË RISKUT

Krijimi i një diagrame që grupon risqe të ndryshme sipas impaktit të tyre, në raport me probabilitetin që ato të ndodhin (pra të hartës së riskut) është metoda më e thjeshtë, që tregon në formë grafike, ato fusha të veprimtarisë së shoqërisë "Porti Detar Vlorë" sh.a, për të cilat duhet të tregojë vemendje të veçantë drejtoria përkatëse. Harta e risqeve përftohet sipas modelit të mëposhtëm

III	II	I
VI	V	IV
IX	VIII	VII

Harta e riskut percakton zonat e riskut me peshë dhe impakt të ndryshëm. Mund të evidentohen 9 zona të tilla:

- I. Zona me prioritet absolut, që kërkon kontrollin permanent nga shoqëria.
- II. Zona me rëndësi të madhe, që kërkon mbikëqyrje të vazhdueshme.
- III. Zonë me rëndësi të madhe por ka pak të ngjarë të ndodhë-kontrolli ciklik
- IV. Zonë me rëndësi të madhe që kërkon kontroll të vazhdueshëm nga ana e nivelit të mesëm dhe të ulët të menaxhimit.
- V. Zonë me rëndësi, që kërkon mbikëqyrje ciklike të nivelit të mesëm dhe të ulët menaxhimi.
- VI. Zonë potencialisht e rëndësishme por me pak probabilitet të ndodhë.
- VII. Zonë kërcënimesh jo shumë të rëndësishme, që kërkon monitorimin në nivel punonjësish.
- VIII. Zonë kërcënimesh pak të rëndësishme që kërkon vetëm mbikqyrje sporadike dhe raportim në periudha kohore të distancuara nga njera-tjetra.
- IX. Zonë kërcënimesh thuajse të parëndësishme.

MONITORIMI DHE RAPORTIMI

Kjo është një etapë që i jep titullarit të shoqërisë liri të plotë në përzgjedhjen dhe vlerësimin e mjeteve dhe metodave të mbikëqyrjes mbi procesin e menaxhimit të riskut. Kjo liri megjithatë është e kushtëzuar nga dy metoda themelore për garantimin e një kontrolli efektiv të risqeve. Këto janë:

- Sistemi i raportimit: Grupi për Çeshtjet e Menaxhimit të Riskut të Brendshëm, një herë në 6 (gjashtë) muaj përgatit një informacion me shkrim lidhur me punën e grupit, të cilin ia percjell titullarit. Përveç kësaj në situatën kur ndoshin ngjarje të caktuara, të cilat kanë ndikim te Menaxhimi i Riskut të Brendshëm, çdo punonjës ka detyrimin për të informuar lidhur me këtë fakt Kordinatorin e Menaxhimit të Riskut të Brendshëm ose eprorin e tij të drejtpërdrejtë. Në rastin e informimit të eprorit të drejtpërdrejtë, ky i fundit ka detyrimin të informojë lidhur me sa më sipër Kordinatorin e Menaxhimit të Riskut të Brendshëm.
- Audit i brendshëm (strukturë e cila nuk është në përberje të shoqërisë “Porti Detar Vlore” sha.

PËRKUFIZIMI DHE PËRSHKRIMI I RISKUT

Risqet më të mundëshme të dhëna më poshtë, ndihmojnë që të fokusohemi në to, por mund të identifikojmë edhe risqe të tjera sipas rrethanave dhe fushës së auditimit.

Modeli i vlerësimit të riskut

Zakonisht risqet ndahen në risqe të brendshëm dhe të jashtëm.

Të brendshëm mund të jenë, risku financiar/ i limiteve buxhetore; risku i IT, risku i burimeve njerëzore, etj.

Të jashtëm mund të jenë ato që shkaktohen nga faktorë jashtë shoqërisë publike por që e ndikojnë atë në bërjen e politikave, strategjive, strukturës, buxhetit, etj. Këto janë jashtë mundësisë së menaxhimit për ti kontrolluar.

Më poshtë identifikohen disa lloje risqesh të cilët mund të ndikojnë shoqëritë publike në përgjithësi dhe ato të shoqërisë «Porti Detar Vlore » sh.a në veçanti.

I. Risku i jashtëm (i ambjentit).

Ky risk vjen kur forca të jashtme ndikojnë në performancën e njësisë ose strategjinë, në operacionet e punës, strukturën, në financimin jo efektiv etj. Risqe të tilla mund të jenë:

1. Risku i përparimit të teknologjisë

Shoqëria është e ekspozuar ndaj riskut të teknologjisë, pasi sot përparimi i saj kërkon ndryshime dhe zëvendësime në operacionet dhe proceset e punës, në përmirësimin e cilësisë, kostos, shkurtimeve të kohës, rritjen e performancës etj.

2. Risku sensitiv

Rezulton kur menaxhimi i burimeve njerëzore dhe flukset monetare të pritshme janë të ndjeshme dhe ndikojnë deri në atë masë sa që ulin tolerancën e njësisë publike, aftësinë për t'i bërë ballë ndryshimeve në forcat e mjedisit që janë krejtësisht jashtë kontrollit të saj.

3. Risku kapitalit në dispozicion



Kur njësia nuk ka burime fondesh të mjaftueshme për të zbatuar programet dhe strategjitë e saj.

4. Risku politik

Është rreziku i pasojave negative përmes veprimeve politike. Në rastin e ndryshimeve politike, njësitet publike ndikohen nga ndryshime në rregulla, organizim, strukturim etj., të cilat kërkojnë kohë, burime dhe ndryshime për tu implementuar.

5. Risku ligjor

Është evident dhe ka të bëjë me rastet kur transaksionet, proceset apo funksionet e ndryshme publike nuk rregullohen dhe nuk kryhen nën një ligj. Kjo shkakton një boshllëk nga i cili mund të shkaktohen dëme që variojnë sipas natyrës së problemit.

6. Risku rregullator

Ndryshimet në rregulla dhe veprime shkaktojnë efekt të dukshëm në eficiencën e aktiviteteve derisa ato të adoptohen plotësisht nga personeli.

II. Risku i brendshëm (i procesit)

Ky risk ka të bëjë me atë që proceset nuk janë qartësisht të përcaktuara dhe jo shumë të lidhura me objektivat dhe strategjitë. Riske të brendshme janë:

1. *Risku i Kontrollit të brendshëm*, i cili ka të bëjë me atë që procesi i qeverisjes së shoqërisë nuk kënaq kërkesat e menaxhimit më të lartë, kur drejtimi dështon në sigurimin e monitorimit të aktiviteteve ekzekutive.

2. *Risku i kulturës së njësive publike*, kur kjo nuk inkurajon menaxherët në marrjen e rezultateve të pritshme

3. *Risku i sjelljes etike*, ku njësia publike përmes veprimit ose mosveprimit tregon që nuk është në përputhje me sjelljet etike dhe të përgjegjshme.

4. *Risku i efektivitetit të menaxhimit*, kur menaxhimi nuk angazhohet në mënyrë efektive dhe nuk siguron mbikqyrjen paraprake të aktiviteteve të njësive.

5. *Risku i operacioneve* që ka të bëjë me atë që operacionet janë ineffiçiente dhe inefektive në arritjen e cilësisë, objektivave dhe kostos së ulët.

6. *Risku i burimeve njerëzore*, lidhet me atë që personeli nuk zotëron njohuritë e duhura, dijet dhe eksperiencën që nevojitet për menaxhimin dhe kontrollin e proceseve, me qëllim reduktimin e risqeve kritike.

7. *Risku i eficiencës së proceseve* të cilat nuk justifikojnë kostot, kur praktikrat dhe politikat e projektuara janë jo bashkëkohore dhe jo në përgjigje të kërkesave të kohës e të vijimësisë.

8. *Risku i ciklit të kohës*, i referohet kohës së fillimit dhe përfundimit të një procesi ose aktiviteteve brenda tij kur ato kanë hapa të panevojshëm, dhe të parëndësishëm.

9. *Risku i përputhshmërisë* shkaktohet si rezultat i moszbatimit të operacioneve të punës në përputhje me ligjet e rregullat për shkak të gabimit njerëzor, indiferencës në mbikqyrje ose/edhe janë të paqarta për ta.

10. *Risku i lidershit* i cili vjen për shkak se drejtuesit apo përgjegjësit e institucionit nuk mund të sigurojnë drejtimin, nuk kanë vizionin e duhur, dhe nuk japin mbështetjen e nevojshme për stafin. Rreziku vjen edhe nga ata drejtues të cilët marrin vendime të cilat nuk janë brenda përgjegjësisë së tyre.

11. *Risku i nxitjes së performancës* jo intensive ka të bëjë me masa jo realiste, subjektive dhe të paqarta që menaxheret mund të marrin për të nxitur rritjen e performancës në një mënyrë që është në kundërshtim me objektivat, standartet etike, me mundësitë etj.

12. *Risku i gadishmërisë* ndaj ndryshimeve, lidhet me atë që njerëzit brenda organizatës nuk janë të aftë të zbatojnë procese ose përmirësime cilësore e sasiore shumë të shpejta për tju përgjigjur ndryshimeve që mund të diktohen nga faktorë të ndryshëm.

13. *Risku i komunikimit* rezulton kur kanalet e komunikimit (lart-poshtë dhe poshtë –lart ose ndër-funksional) brenda organizatës janë joefektive si dhe rezultojnë në kundërshtim me përgjegjësitë e autorizuara ose masat e vendosura.

14. *Risku i teknologjisë* së informacionit, shkaktohet nga mos efienca dhe mos efektiviteti i teknologjisë ekzistuese e cila nuk është në gjendje të mbështesë dhe ti përgjigjet nevojave korrente dhe të ardhme të proceseve të punes.

15. *Risku i aksesit* përfshin ato risqe nga aksesit për informacion (të dhëna ose programe) ose i sistemeve kur ato nuk janë të përshtatshme. Kjo përfshin rreziqe nga ndarja jo e duhur e detyrave, rreziqe që lidhen me integritetin e të dhënave dhe bazës së të dhënave ose me konfidencialitetin e informacionit.

16. *Risku i disponueshmërisë* është risku që informacionet nuk mund të jenë të disponueshme atëherë kur ato nevojiten. Kjo mund të vije nga humbja e komunikimit, (për shkaqe teknike e dëmtime, etj), nga humbja e aftësisë së përpunimit bazë (nga zjarri përmbytjet, ndërprerje energjie etj), dhe nga vështirësi operacionale (prishje e diskut, gabime të operatorit etj).

17. *Risku i infrastrukturës* në rastet kur organizata nuk ka një infrastrukturë për sistemin e TI-së (hardëare, netëorks, softëare, njerëz etj) të cilët të mbështesin efektivisht nevojat korrente dhe të ardhme të veprimtarisë.

III. Risku i integritetit

Është rreziku i mashtrimit të menaxhimit, mashtrimit të punonjësve, dhe akteve të paligjshme dhe të paautorizuar, të cilat mund të çojnë në shpërdorim financiar, të detyrës apo reputacionit në publik.

1. Risku i mashtrimit të menaxhimit

Çështjet e menaxhimit lidhur me mashtrimin me tregues financiare, pasqyrat financiare etj me qëllim që të mashtrojnë publikun dhe audituesit, ose të angazhohen në marrje rryshfetesh, shantazh, ndikimin në pagesat dhe skema të tjera si këto.

2. *Risku i mashtrimit* të të punësuarve nga palët e treta. Aktivitetet mashtruese të kryera nga punonjësit, persona të tretë kundër organizatës për përfitime personale duke shkaktuar humbje për njësinë publike.

3. Risku i veprimeve të paligjshme

Menaxherët dhe punonjësit në mënyrë individuale ose në grup kryejnë veprime të paligjshme duke shkaktuar konsekuenca nga veprimet e tyre për organizatën.

4. Risku nga veprimi në mënyrë të pa autorizuar

Punonjësit ose të tjerë përdorin asetet financiare ose fizike të njësisë publike për qëllime të pa autorizuara ose jo etike (nevoja personale).

IV. Risku Financiar

Risku financiar mund të ndodhë në qoftë se kompania nuk arrin të sigurojë buxhetin e nevojshëm për të përmbushur detyrimet e saj ose menaxhon rreziqet financiare në një mënyrë që është në kundërshtim me rregullat në fuqi.

1. Risku i përqëndrimit

Reziqet që vijnë nga përqëndrimi i burimeve në mënyrë të padrejtë në pak funksione duke lënë pas dore të tjerat si dhe jo në përputhje me objektivat.

2. Risku i kredisë

Ekspozimi ndaj humbjeve reale për shembull nga mos pagimi i detyrimeve kreditore. Në një kontekst tjetër mund të jetë rreziku nga shpenzime të papritura dhe/ose nga pengesa administrative lidhur me dështimin për të kryer pagesa në vendin dhe kohën e duhur.

V. Risku i informacionit për marrjen e vendimeve



Rreziku që informacioni i përdorur për të mbështetur vendimet strategjike, operative dhe financiare nuk është ai i duhuri ose i besueshëm. Ky rrezik lidhet edhe me përdorshmërinë dhe afatet kohore të informacionit, ose nga një dështim për të kuptuar nevojat e informacionit.

V. Risku Operational

1. Risku i buxhetit dhe planit

Kur buxhetet dhe planet nuk janë reale, të bazuara në supozime të përshtatshme, në koston reale dhe masave të përshtatshme të performancës, të pranuar nga drejtuesit kryesorë, ose të përdoren si mjet monitorimi.

2. Risku nga angazhimet e kontratës

Njësia nuk zgjidh në kohë, dhe pa implikime financiare vendimet për të hyrë në angazhimet shtesë/kontrata shtesë të cilat mund të konsiderohen të papërshtatshme nga vendimmarrësit.

3. Risku i matjes së operacioneve

Masat e matjes së performancës të operacioneve nuk sigurojnë performancën, nuk pasqyrojnë me saktësi realitetin, nuk japin informatat e duhura, sepse nuk janë të dobishme, të kuptueshme.

4. Risku i shtrirjes

Objektivat dhe masat për kryerjen e proceseve të punës të njësisë publike, nuk janë të lidhur me objektivat e saj të përgjithshme dhe as me strategjitë. Objektivat dhe masat nuk fokusojnë njerëzit në gjërat e duhura dhe si rrjedhim çojë në konflikte, ose aktivitete të pa koordinuara.

5. Risku i informacionit kontabël

Informata financiare kontabël të përdorura për të menaxhuar proceset të pa integruara si duhet me informata jo financiare, si shërbimi ndaj publikut, matjen e cilësisë së punës, kursimin e kohës të një aktiviteti dhe rritjen e efikasitetit. Rezultat i tillë manipulon duke bërë që dhe fokusi të jetë arritja e objektivave financiare, në vend të përmbushjes së shërbimeve publike, kontrolli dhe përmirësimi i proceseve.

VI. Raportimi publik

1. Vlerësimi i Riskut të Raportimit Financiar

Raportet financiare të lëshuara përfshijë anomali materiale ose kanë hequr fakte materiale.

2. Vlerësimi i riskut të Kontrollit të Brendshëm

Dështimi për të grumbulluar informacion të mjaftueshëm, të përshtatshëm dhe të besueshëm për të vlerësuar efektivitetin e projektimit dhe operimit të kontrollit të brendshëm mbi raportimin financiar, duke rezultuar në pohime të pasakta nga drejtuesit në raportin e kontrollit të brendshëm.

3. Risku i Tatimeve

Transaksione që kanë pasoja negative tatimore që mund të ishin shmangur sikur të ishin strukturuar ndryshe. Dështimi për të përmbushur me të gjitha rregulloret dhe detyrimet e taksave (p.sh. deklarimi dhe pagesa e TAP dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, krijon rreziqe për kosto shtesë nga penalizimet).

C. Risku Strategjik

1. Risku mjedisor

Dështimi për të monitoruar dhe të qëndruar në kontakt me një mjedis që ndryshon me shpejtësi, rezulton të sjellë vijimin në mbështetjen në strategjitë e vjetëruara dhe të papërditësuara.

2. Risku i modelit të operacioneve

Organizata ka një model të vjetëruar të operacioneve dhe nuk e njeh atë, nuk ka informacionin e nevojshëm për të bërë një vlerësim të përditësuar të modelit të saj të tanishëm dhe për të ndërtuar një rast bindës të operacioneve për të modifikuar këtë model në kohën e duhur.

3. Risku i vlerësimit të investimeve

Menaxhimi nuk ka informata të mjaftueshme financiare për të informuar vendimet afatshkurtëra dhe afatgjata të investimeve dhe rreziqet e pranuar në lidhje me kapitalin në rrezik. Menaxhimi dhe vendimarrësit duhet të jenë në gjendje të matin efektet e investimeve në kontekstin strategjik.

4. Risku i Strukturës Organizative

Struktura organizative e njësisë nuk e mbështet ndryshimin ose strategjitë e funksionimit të saj.

5. Risku i matjes

Ndodh kur matja e përgjithshme organizative e performancës përqëndrohet kryesisht në rezultatet afatshkurtra financiare ose nuk janë në përputhje dhe nuk mbështesin strategjitë e veprimtarisë.

6. Risku i planifikimit

Strategjitë e operacioneve të njësisë nuk janë të shtyra nga të dhëna krijuese, ose nuk janë bazuar në supozime aktuale e reale.

Procesi i Vlerësimit të riskut

Sigurisht, jo të gjitha ngjarjet me rrezik që ne identifikojmë janë po aq të rëndësishme.

- Ato që janë shumë të rëndësishme janë kategorizuar si “risqe të zonës së kuqe” që kërkojnë vëmendje të veçantë.
- Ato që janë mesatarisht të rëndësishme janë kategorizuar si “risqe të zones së verdhë”, dhe tregojnë nevojën për kujdes, dhe,
- Ato që janë të parëndësishme janë kategorizuar si “risqe në zonën e gjelbër”.

Ndryshe kategorizohen: risk i lartë, i mesëm dhe i ulët.

Pasi identifikohen risqet dhe klasifikohen, vëmendje u kushtohet pasojave të shfaqjes së ngjarjeve të rrezikut, sidomos ngjarjet e zonës së kuqe.

Për shembull, nëse risqet ndodhin, a do të këtë rritje të mëdha në shpenzime?

Sa mund të jetë rritja në vlerë? Cilat funksione, fusha ndikohen ose dëmtohen?

Përpjekjet për të analizuar pasojat e shfaqjes së risqeve, quhen analiza e ndikimit të riskut.

Analiza e ndikimit të riskut ndahet në dy pjesë: analiza cilësore dhe sasiore.

a) Me analizë cilësore, kuptojmë përpjekjet për të shqyrtuar ndikimet e ngjarjeve të rrezikut kryesisht përmes zbatimit të një procesi të arsyetimit logjik.

Efektiviteti i analizës cilësore varen nga përvoja, logjika, dhe gjykimi i mirë.

b) Me analizën sasiore, ne përpiqemi të matim pasojat numerikisht.

Për shembull, nëse një ngjarje negative ndodh sa do të jetë humbja apo ndikimi në buxhet? Cila është vlera e humbjeve? Sa kohë do të marrë riparimi i saj?

Përgjigjet për këto lloj pyetjesh kërkojnë njohuri për të zhvilluar strategji në përgjigje të rrezikut.

Shembull:



Cilat janë pasojat financiare të një ndërprerje treditore të punës së një sofëar-i të financës? Një numur i madh transaksionesh do të ndërpriten, dhe mos kryerja në afat mund të shkaktojë efekte financiare si pagesa penalitësh për vonesa, interesa, pezullim të përmbushjes së punës, shërbimit etj. Kjo ngjarje duhet parashikuar, por njëkohësisht edhe buxheti shtesë për përballimin e pasojave të saj.

Procesi i Monitorimit dhe kontrolli i riskut

Procesi i fundit i menaxhimit të riskut është monitorimi dhe kontrolli.

Kjo është fazë e veprimit të menaxhimit të riskut. Proceset e mëparshme të rriskut si te planifikimi, identifikimi, analiza cilësore, analiza sasiore, kërkojnë ndërmarje të veprimeve të tjera për minimizimin e pasojave. Kërkohet se çfarë hapash mund të ndërmerren për të lehtësuar dëmtimet e mundëshme.

Me monitorimin dhe kontrollin e riskut, kuptojmë dy komponentë të rëndësishëm. Monitorimi nënkupton se menaxherët vazhdimisht skanojnë risqet për të parë se çfarë kanosin ngjarjet negative që mund të shfaqen. Monitorimi i rriskut është si të bësh kontrolle periodike për të vlerësuar presionin e riskut. Kur shigjeta është në zonën e gjelbër, çdo gjë është në rregull. Kur ajo është në zonën e verdhë, ne kemi nevojë për t'u përgatitur për veprim. Kur ajo është në zonën e kuqe, ne duhet të ndërmarrin hapa konkrete për të pakësuar trysninë.

Monitorimi i rriskut është një përpjekje e grumbullimit të informacionit, të veprimtarive të kryera gjatë rrjedhës normale të punës, me qëllim për të përcaktuar nëse ndonjë ngjarje risku është reflektuar dhe, nëse ato janë mjaftueshëm seriozë për të garantuar/dëmtuar një aktivitet. Monitorimin i rriskut është një proces thujse rutinë që kryhet për të shmangur surprizat e këqia.

Një pjesë e madhe e monitorimit të riskut është informale. Ndërsa punonjesit janë duke bërë punën e tyre, duhet të jenë të ndjeshëm ndaj gjërave që nuk duken të drejta ose normale. Në qoftë se çdo punonjës është i ndjeshëm për anomali apo problemet potenciale, niveli i rriskut të organizatës reduktohet në masë të madhe me anë të përpjekjeve të tyre të monitorimit informal.

Kontrolli ka të bëjë me veprimet aktuale që ndërmarrim për të trajtuar rastet e rriskut. Kur diskutohet kontrolli, ai nënkupton që përqendrohet vëmendja e veçantë në hapat e menaxhimit të krizës, të cilat duhet të merren.

Kontrolli i riskut, i cili është quajtur shpesh trajtimi i riskut, i referohet hapave që janë ndërmarrë për të marrë ngjarjet nën kontroll pasi të kenë ndodhur. Nëse një veprim dështon duhet ndërmarrë një veprim tjetër i kontrollit për të zbatuar një plan rezervë për minimizimin e dëmit.

Përgatiti

Ilir BANUSHI

ADMINISTRATOR